

**AKT THEMELIMI  
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
“J & K SOLUTIONS ”SH.P.K**

Sot me datë 16.10.2024, në Tiranë në mbështetje të ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqërítë tregtare”, u hartua ky akt themelimi nga ortakët themelues të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar nga Z. Ioannis Paradakis si më poshtë vijon:

**NENI 1  
THEMELIMI DHE EMRI I SHOQËRISË**

Krijohet shoqëria me përgjegjësi të kufizuar **“J & K SOLUTIONS ”SH.P.K.**  
Shoqëria do të zhvilloje aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me Aktin e Themelit dhe Statutin e saj.

**NENI 2  
SELIA**

Selia e Shoqërisë ndodhet në Rruga Ali Demi, P. 259, shk.1, k.1, ap. 3, Tiranë dhe mund të ndryshojë selinë e saj me vendim të asamblesë së ortakëve.


**NENI 3  
FORMA**

Kjo Shoqëri është një Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar

**NENI 4  
OBJEKTI I VEPRIMTARISË**

Tregtim me shumicë e pakicë të mallrave industriale, lëndë të parë, hidraulike, panele diellore per ngrohjen e ujit sanitar, materiale elektrike, elektroshtepiake, hidrosanitare dhe sistemeve te ngrohje-ftohjes . Tregti me shumice dhe pakice, import export, te kondicionerve dhe frigifereve per shtepi dhe atyre komercial dhe industrial, sistemeve te ajerimit, ngrohjes dhe ftohjes, aksesoreve te tyre , materialeve per instalim dhe mirmbajte , projektim dhe instalim te ketyre sistemeve, mirëmbajtje dhe riparim te sistemeve te kondicionimit, konsulencë teknike dhe teknologjike, mbikqyrje teknike, sherbime, perfaqesi dhe ndërmjetësi tregtare, blerje artikuqsh dhe sendesh te tjera me qellim rishitje ne pamjen e tyre fillestare, te ripunuar ose te perpunuar per sistemet e ajerimit, ngrohjes dhe ftohjes. Tregtim i gasit te legnshem natyrore me pakice dhe shumice, blerje, shitje, import dhe eksport te bombulave te gasit GLN dhe bombulave te gazit per sistemet e kondicionimit , frigorifereve dhe cdo pajisje tjeter. Tregtim I vajrave mineral dhe lubrifikanteve.

**NENI 5**



## **KOHËZGJATJA**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë e pakufizuar (e pacaktuar), duke filluar nga data e rregjistrirnit në Qendren Kombëtare të Biznësit, me përjashtim të rastit të mbarimit të saj sipas kushteve të parashikuara në ligj ose me vendim të asamblesë së ortakëve,

## **NENI 6 KAPITALI THEMELTAR**

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100,000 lekë.

Ky kapital është tërësisht i nënshkruar dhe i shlyer nga ortakët e shoqërisë. Shoqëria mund të shtojë ose zvogëlojë kapitalin, në varësi të nëvojave dhe rezultateve te saj, sipas vendimit të ortakëve .

Kapitali themeltar i shoqërise është i përbërë nga kontributi i Ortakut të Shoqërisë :

- Z. Ioannis Paradakis, zotëron 1 ( një ) kuotë me vlerë 100.000 ( Njëqindmijë ) lekë.

## **ORGANI DREJTUES**

## **NENI 7 ASAMBLEJA E ORTAKËVE**

Asambleja e Ortakëve zotëron të gjitha kompetencat që i njihen me ligj për shkak të kësaj cilësie.

## **NENI 8 ADMINISTRATOR**

Shoqëria do të drejtohet nga administratori i saj, Kostantinos Papyrakis, i 18/02/1980, zotërues i leternjoftimit grek nr. AM962421.

## **NENI 9 FITIMI**

Të ardhurat neto të shoqërisë i takojnë ortakëve themelues të shoqërisë.

## **NENI 10 BILANCI**

Viti finansiar fillon në 1 janar dhe përfundon me 31 Dhjetor të cdo viti.

Llogari të vjetore, inventari, raportet mbi operacionet e vitit finansiar dhe raportet hartuara nga eksperti kontabel, miratohen nga asambleja e ortakëve.

Miratimi i dokumentave mbi veprimtarinë vjetore bëhet brënda një afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes së vitit finansiar.



**NENI 11  
KONFLIKTET**

Konfliktet që mund të lindin midis palëve do të gjykojnë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, sipas statutit të shoqërisë, kontratës të lidhur me palët dhe në zbatim të legjislacionit shqiptar.

**NENI 12  
VULA DHE SHENJA DALLUESE**

Shoqëria ka vulenë dhe shenjat e veta dalluese.

**NENI 13**

Ky akt themelimi do të hyjë në fuqi pas marrjes së lejes nga organet kompetente.

**NENI 14**

Akti i themelimit u perpilua në katër kopje origjinale ne gjuhën shqipe me vlerë të njëjtë.

**ORTAKU I VETËM I SHOQËRISË**

**Ioannis Paradakis**

Ιωάννης Παραδάκης

